



**Qendra Kinematografike e Kosovës  
Centar za Kinematografiju Kosova  
Kosova Cinematography Center**

---

## **MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT**

**I LIDHUR**

**NDËRMJET**

**QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS**

**DHE**

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS - “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETIT TË ARTEVE**

## **1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT**

Qëllimi i këtij memorandumi të bashkëpunimit është mbështetja financiare e Studentëve të fakultetit të arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në prodhimin e filmave të diplomës dhe angazhimi i studentëve të fakultetit të arteve në projektet të cilat i subvencionon Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK).

## **2. BAZA LIGJORE**

Marrëveshja e bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës dt. 12.03.2010, përkatësisht neneve 3,4,5,6 pika 3 e 4 dhe nenit 7 të marrëveshjes.

## **3. AUTORITETET**

Qëllimi i memorandumi përmbushet nga:

- Qendra Kinematografike e Kosovës, (QKK) dhe
- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” - Fakulteti i Arteve

## **4. OBLIGIMET E PALËVE**

### **4.1 OBLIGIMET E QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS**

QKK, sa i përket qëllimit të këtij memorandumi merr përsipër obligimet si në vijim:

- QKK, përmes fondit për kinematografinë çdo vit do të ndaj vlerën deri në 20,000.00€ (njëzetmijëeuro) për përkrahjen e filmave të diplomës për studentët në programin e rregullt të studimeve pranë Fakultetit të Arteve të UP-së “Hasan prishtina”. Kjo vlerë do të ndahet për filmat e diplomës bachelor.
- QKK, në marrëveshje me produksionet filmike të regjistruara në QKK, i angazhon në cilësinë e asistentëve të regjisë, të skenarit, të drejtorit të fotografisë (kameramanit), të skenografisë, të kostumografisë etj. studentët e drejtimeve përkatëse, ndërsa, varësisht nga kërkesat e produksioneve filmike, mund t'i angazhoje në projekte të ndryshme filmike edhe studentët e aktrimit.
- QKK, do ti shpërndajë mjetet varësisht nga numri i studentëve që aplikojnë për këtë fond, por pa e kaluar vlerën prej 20,000.00€ (njëzetmijëeuro).

### **4.2. OBLIGIMET E FAKULTETIT TË ARTEVE**

Fakulteti i arteve, sa i përket qëllimit të këtij memorandumi merr përsipër obligimet si në vijim:

- Fakulteti i Arteve, obligohet që Qendrës Kinematografike të ia dorëzojë listën e studentëve që janë të gatshëm për diplomim dhe që i kanë plotësuar kushtet dhe procedurat administrative të parapara nga Fakulteti për mbrojtjen e diplomës.

- Listat i dërgohen QKK-së dy herë në vit. Afati për dërgimin e listave është 15 Janari dhe 15 Korriku.

## **5. PËRFITUES NGA MEMORANDUMI**

Përfitues nga ky memorandum janë studentët e fakultetit të arteve të UP-së “Hasan Prishtina” në këto pika:

- Të drejtë konkurimi për fond e kanë studentët që i kanë plotësuar kushtet procedurale dhe administrative pranë fakultetit për punimin e temës së diplomës (filmin e diplomës).
- Të drejtë për tu angazhuar në projektet që QKK i subvencionon sipas pikës 4.1 paragrafi 3 e kanë të gjithë studentët e fakultetit të arteve.

## **6. ZBATIMI**

Qendra Kinematografike e Kosovës në bashkëpunim me fakultetin e Arteve përcjellin zbatimin e këtij memorandum bashkëpunimi dhe udhëzojnë veprimet që duhet të ndërmerren për implementimin e obligimeve të ndërsjella.

### **MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPANASHIKUARA**

- Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve.
- Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të fuqisë mbinaryrore – Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

## **7. AFATI**

Ky memorandum bashkëpunimi lidhet për periudhë 3 vjeçare.

Ky memorandum bashkëpunimi fillon të zbatohet nga viti 2014.

## **8. AMANDAMENTIMI**

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Memorandum në të ardhmen, apo në një amendament të këtij Memorandumi, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

Me pajtimin e të dyja palëve ky memorandum, 3 (tre) muaj para skadimit të saj mund të përsëritet për një afat më të gjatë kohorë dhe varësisht nga nevoja, mund të ndryshohet, të modifikohet me forma tjera shtesë të bashkëpunimit.

## **9. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJES**

Kjo memorandum bashkëpunimi mund të anulohet në mënyrë të njëanshme nëse ndonjëra nga palët nënshkruese nuk i përmbush obligimet e përcaktuara.

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime e mirëkuptim, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë.

## **10. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në katër (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

## **11. HYRJA NË FUQI**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Arben Zharku  
Drejtori i  
Qendrës Kinematografike të Kosovës

Adem Rusinovci  
Dekan i  
Fakultetit të Arteve të UP-së "Hasan Prishtina"

---

v.v

---

v.v